

Ftesë për Shprehje të Interesimit

Data: 28.07.2023

Nr. 108/23

Emri i kontratës: Konsulent vendor për hartimin e Strategjisë pesë vjecare të Organizatës Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

1. Rreth organizatës

Forum i Kosovari i Aftësisë së Kufizuar është organizatë jofitimprurëse ombrellë dhe mekanizëm përfaqësueses i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, e cila përfaqëson, mbron dhe promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të unifikuar dhe pa asnjë dallim.

Termet e Referencës

2. Objektivi

Forum i Kosovari i Aftësisë së Kufizuar synon të angazhojë një konsulent të specializuar për hartimin e dokumentit strategjik të organizatës

3. Shërbimi që duhet të ofrohet

Hartimi i Strategjisë pesë vjecare të organizatës Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

4. Përvoja dhe shkathtësitë e nevojshme

Konsulenti/ja duhet t'i ketë kualifikimet dhe shkathtësitë thelbësore të mëposhtme:

- Diplomë pas universitare (preferohet grada Master në ndonjë fushë të ndërlidhur me shkencat shoqërore).
- Njohja e mirë e funksionimit të organizatave jo qeveritare dhe sistemit të menaxhimit të tyre (trajnimet në këtë fushë konsiderohen përparësi).
- Përvojë e punës në fushën e aftësisë së kufizuar.
- Përvojë paraprake në realizimin e dokumenteve strategjike organizative të natyrës së ngjashme;
- Aftësi për të hartuar raporte koncize dhe me cilësi të lartë, në format të kuptueshëm për lexuesin, duke shfaqur shkathtësi të shkëlqyeshme analitike;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe prezantimit para audiencave me njohuri dhe shkathtësi të ndryshme teknike;
- Kreativ, i/e hapur për konsultime dhe pranon sugjerime;
- Aftësi për të ju përmbajtur planeve të punës.

5. Afatet kohore

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Ditët e punës /orët	Afatet Kohore
1	Analiza e kontekstit të fushës	2	Shtator
2	Takimi për marrjen e inputeve nga grupet e interesit dhe akteret e tjere	3	Shtator
3	Hartimi i objektivave strategjike dhe drafti i pare i planit strategjik	7	Shtator
4	Takimi i dytë për prezantimin e objektivave dhe marrjen e komenteve	1	Shtator
5	Adresimi i komenteve dhe finalizimi i strategjise	2	Tetor
6	Takimi me grupet e interesit per zhvillim e planit te veprimit 1 vjecar te strategjise (zhvillimi i aktiviteteve)	2	Tetor
7	Adresimi i komenteve dhe finalizimi i planit nje vjecar te veprimit	2	Tetor
Total ditë pune		19	

6. Si të aplikoni?

Kandidatët e interesuar janë të mirëseardhur të aplikojnë duke dorëzuar dokumentacionin e listuar më poshtë, në emailin prokurimi@kdf-ks.org me subjekt: **Konsulent/e për të hartuar strategjinë FKAK-së**. Në aplikim duhet të përfshini:

- b) Curriculum Vitae (CV).
- c) Metodologjia dhe plani i veprimit
- d) Dëshmi të tjera të eksperiencës në fushën e ngjajshme

Pas krahasimit dhe vleresimit te dokumenteve te pranuar nga komisioni, kandidatit me numrin me te larte te poenave do t'i kerkohet oferta financiare.

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kualifikimi/Niveli i arsimimit	40
Metodologjia dhe plani i veprimit	30
Përvoja e mëhershme për shërbime të ngjajshme	30
Total	100

Afati i fundit për aplikim është: deri 15.08.2023. ne ora 16:00 ne email adresen prokurimi@kdf-ks.org

Dokumentet e derguara pas afatit te caktuar nuk do te pranohen!